



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Bujar Kuçi	18.05.2026	25.05.2026	2026/0317

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 15.05.2026, OE “KOSOVA MOTORS GROUP ” S H.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0317, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë GOE "AGS Corporation dhe Auto Kacandolli"- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-ne-Ritender” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11147-1-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur,

Lloji i kontratës: Furnizim,

Vlera e parashikuar e kontratës: 243,000.00 €.

Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP - së, më Nr. 2026/0317 i dt:15.05.2026. Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 - Qëllimi;

Neni 7 - Barazia në trajtim/ Jo-Diskriminimi;

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;

Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës.

Duke analizuar vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 06.05.2026, ne OE Kosova Motors Group sh.p.k.,(tutje: "KMG") si operator ekonomik i cili e paraqet këtë ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (tutje: "OSHP") kundër njoftimit të AK-së për dhënie të kontratës dhe kundër vendimit të AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim i datës 06.05.2026, konstatojmë se në këtë ankesë do i paraqesim në vijim pretendimet dhe dëshmitë tona që kanë të bëjnë lidhur me vendimin e AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim dhe rekomandimin e kundërligjshme për dhënien e të kontratës. Shihet kjo se AK nuk i ka marrë përbazë fare argumentet tona të prezentuara në kërkesën për rishqyrtim i datës 30.04.2026 e të cilat i gjeni të gjitha të bashkangjitura në lëndën e kësaj ankese respektivisht në kërkesën për rishqyrtim e parashtruar nga ana jonë e cila është refuzuar pa të drejtë nga AK. I njëjti nuk ka dhënë asnjë mendim shtesë përpos se i ka bërë copy-paste arsyet e saja paraprake të cilat vetemse kanë qenë të paraqitura në raportin e vlerësimit, konkretisht në letrat standarde të datës 28.04.2026., shikoje dëshminë në vijim,citoj:

Arsyet me larte janë te paraqitura ne Raportin e Vlerësimit Letrat Standarde te Prandaj ky pretendim OE është i pa bazuar.

Kjo shpie drejt shkeljës së Nenit 7 të LPP-së sepse AK nuk ka bërë trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik. Tutje, ju lutem na lejoni ti parashtrojmë pretendimet tona se përse AK edhe në vendimin e saj të refuzimit të kërkesës për rishqyrtim ka bërë shkelje flagrante të LPP-së duke refuzuar pa të drejtë ofertën tonë e cila ofertë është e përgjegjshme dhe pretendimet tona apo faktet tona të prezentuara te AK se përse GOE i rekomanduar për kontratë nuk qe i përgjegjshëm dhe se në kundërshtim me Nenin 59 dhe 60 të LPP-së, AK e ka përzgjedh si të përgjegjshëm GOE në fjalë. Në vendimin e AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, AK pretendon si në vijim, citoj:


Ne DT dhe Njoftim per Kontrate është kerkuar si ne vijim:

Kërkesa I Garancion nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit mbi garancion i minimum 24 muaj nga data e pranimit finale te furnizimeve.

1. OE ka sjelle deklarate ne kundërshtim me kriterin e AK, ku ka ofruar 24 muaj/150.000k Andaj ky kushtezim eshte I papranueshem.

Është e pabazuar pretendimi i AK-së sepse ne kemi ofruar 24 muaj garancion. Për më tepër në leter garancionin zyrtar të prodhuesit të platformës konfirmohet si në vijim, citoj:

We hereby declare as well that our offered products in this procurement activity comes with 24 Months warranty.



Handwritten signature and stamp of Maschinenbau-Union GmbH.

Në dosje të ankesës e gjeni garancionin e prodhuesit dhe njëherit e gjeni edhe shkresën zyrtare të datës 03.03.2026 me të cilën shkresë AK i drejtohet prodhuesit për konfirmim të vërtetësisë të dokumenteve dhe konfirmimit të validitetit dhe origjinalitetit të dokumenteve të lëshuara nga prodhuesi i cili me po të njëjtën datë i kthen zyrtarisht shkresën tek AK. (Bashkangjitur

gjeni dokumentin titulluar mail_001.zip). AK ka vepru njëjtë edhe me prodhuesin tonë MAN. Me datë 04.03.2026 dhe 06.03.2026 i drejtohet zyrtarisht për konfirmim të validitetit dhe origjinalitetit të dokumentacionit në fjalë dhe po të njëjtën ditë i kthehet AK-së e-maili zyrtar. (Bashkangjitur e gjeni dokumentin titulluar mail_002.zip. Prodhuesit e mjeteve motorike ofrojnë garancion me vite dhe kilometra varësisht përdorimit të tyre. Në këtë rast AK ka bërë shkelje të Nenit 7 të LPP-së sepse nuk e ka marrë për bazë fare pretendimin tonë që jemi deklaruar se edhe GOE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tij e ka të njëjtën kriter, citoj:

Në web-faqen zyrtare të prodhuesit të OE Ankues citohet si në vijim: "In addition to the 12 month warranty with unlimited mileage for the complete vehicle, the extended Mercedes-Benz Trucks warranty extends to 36 months for parts of the drivetrain. It affects parts groups in the engine, transmission, drive shaft(s) and drive axle(s) up to a maximum of 450,000 km depending on the type of use". Kjo konfirmon se në limiti i kilometrave në politikat e garancisë së tyre shkon deri maximum 450,000 km. Referoju web-faqes zyrtare të prodhuesit Mercedes Benz ku pretendimi ynë i lartëcekur vërtetohet: <https://www.mercedes-benz-trucks.com/int/en/trucks/arocs.html> Këtë pretendim si dëshmi e gjeni edhe në katalogun e kompanisë ankuese, në vijim kjo shihet:

X3W	Powertrain warranty as per T and Cs 3yrs/450,000km
Y4Z	Compressed-air gun, with hose

P 252.00.00/D 120.00.01

page 3/6

Arocs 5 1833 L 4x2 B 11

AK as nuk e ka komentuar fare këtë pretendim dhe si rrjedhojë e kësaj, AK e ka shkel Nenin 7 të LPP-së. Prandaj ne deklarojmë se e plotësojmë këtë kriter dhe se në përputhje me Nenin 59 pika 2, AK ka pas mundësi të kërkojë sqarime shtesë nga ana jonë në lidhje me këtë çështje e jo të na diskualifikojë pa të drejtë nga pjesëmarrja marrë parasysh këtu se kemi qenë OE i rekomanduar për kontratë derisa GOE ankues bëri kërkesë për rivlerësim e cila quditërisht ju aprovua marrë parasysh se me çmim janë më të lartë nga oferta jonë e përgjegjshme.

Sa i përket çështjes së Tahografit jemi deklaruar se e plotësojmë këtë kriter me përplotmëri dhe do e liferojmë produktin në përputhje të plotë me specifikimet teknike. Poashtu sa i përket pretendimit për dritë rotative siç edhe jemi deklaruar, e njëjta përputhet në përplotmëri me specifikimet teknike, ju lutem referojuni katalogut tonë dhe kërkesës për rishqyrtim ku i gjeni të gjitha informatat në lidhje me këtë çështje sepse dëshirojmë të mënjanojmë reprizat apo përsëritjet e deklaratave të cilave i rrijmë mrapa me ato të përmendura në dokumentet e lartëcekura.

Në vendimin mbi Refuzim, Pretendimi 1, citoj:

- **Pretendimi 1**-OE ankues pretendon qe pretendon qe katalogu i o rekomanduar për kontrate nuk ka prejardhje nga prodhuesi.

Komisioni i vlerësimit ka bere verifikimin e dokumenteve , Autorizimet, katalogët nga personat e autorizues e për te cilat ne kemi konfirmim autentike dhe te vlefshme. Andaj kjo nuk qëndron.

AK në DT Seksioni II - Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, Kërkesa 2 kërkohet **katalog nga prodhuesi** me përshkrim të detajuar, me të cilin është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara. GOE i rekomanduar për kontratë e ka paraqitur një katalog të krijuar nga vet ai dhe jo nga prodhuesi siç kërkohet. Si dëshmi shihen të dhënat e Kompanisë në katalog, shikoje në vijim:

Mercedes-Benz Arocs 5 1833 L

Auto Kaçandolli

30/01/2026

Salesman: Dardan Qorri

Kjo konfirmon pretendimin tonë se katalogu e ka prejardhjen nga vet Kompania dhe jo Prodhuesi.

Për më tepër, pretendimi i AK-së si në vijim, citoj:

Komisioni i vlerësimit ka bere verifikimin e dokumenteve , Autorizime katalogët nga personat e autorizues e për te cilat ne kemi konfirmim autentike dhe te vlefshme. Andaj kjo nuk qëndron.

Nuk qëndron fare ky pretendim i AK-së, është në kundërshtim me Nenin 59 të LPP-së. Është kërkuar katalog nga prodhuesi ndërsa është prezentuar katalog i krijuar nga Kompania dhe kjo është e vërteta.

Në vendimin mbi Refuzim, Pretendimi 2, citoj:

- **Pretendimi 2**- OE ankuese pretendon qe OE e rekomanduar nuk

7 Sistemi i drejtimit : Servo Hidraulik-Timoni në anën e majt. Pretendon qe Timoni i ofruar ne katalog eshte elektrik

C6I Power steering Hydraulic pump, controlled

Power nuk steering nënkupton sistem drejtimi elektronik.

Power (ne përkthimnga anglisht - fuqia)

Andaj është pomp hidraulike dhe jo elektronike

Andaj pretendimi nuk qëndron

Është ofruar timon elektrik, në anglisht Power steering nënkupton timon elektrik!.

Në vendimin mbi Refuzim, Pretendimi 3, citoj:

- **Pretendimi 3** –i OE ankues qe Mak Autostar DOEL ka auto është dokument jorelevant dhe nuk ka qene kriter kualifikues, dhe kualifikuese nuk merren parasysh. Megjithatë kjo është një ble përfundon me dorëzimin e mallit (180 dite).

Pretendimi i AK-së nuk qëndron sepse edhe pse nuk ka qene kriter kualifikues mbi të gjitha është dokument egzekutues që konfirmon ndër tjerash edhe atë si në vijim, citoj:

The authorization includes the sale of new vehicles, genuine s Diagnostics Hard-/Software, Xentry Truck Software and the s contract territory. MAK AUTOSTAR D.O.O.E.L. is responsible for the above-mentioned territory and authorized to appoint sales ar

Deklarata e lartëpërmendur konfirmon mbi gjitha edhe përfshirjen e shërbimeve të servisit të kamionit në territorin kontraktues. Kjo nënkupton se deri me datë 31 dhjetor 2026 ka të drejtë të servisohen automjetet në fjalë dhe pas kësaj date skadon kontrata në mes të prodhuesit dhe dilerit të autorizuar. Me këtë konfirmohet se GOE nuk është i përgjegjshëm sepse nuk mundet të mirëmbajë kamionin nën garancion 24 mujor marrë parasysh skadimin e kontratës në mes të palëve të lartëcekura. Me këtë rast vlen të ceket se me mos marrjen parasysh të pretendimit tonë, AK bëri shkelje flagrante të Nenit 7, 59 dhe mbi të gjitha Nenit 60 të LPP-së sepse nuk e ka respektuar ofertën tonë e cila është e përgjegjshme dhe më e ulët me çmim nga të tjerët, është ndikuar nga veprimet e GOE të rekomanduar për kontratë. I ftojme AK-në dhe i bëjmë thirrje edhe GOE të rekomanduar për kontratë që të respektojnë kriterin për dhënie të kontratës që kjo të ceket në DT që është oferta e përgjegjshme çmimi më i ulët prandaj për rekomandim për dhënie të kontratës rekomandohemi ne, konkretisht Kompania Kosova Motors Group sh.p.k., e jo GOE i rekomanduar për kontratë marrë parasysh se i njëjti është me çmim më të lartë nga oferta e jonë.

Për fund: I lutemi OSHP-së që të vlerësoj ankesën tonë, ta trajtojë me kujdes dhe të njëjtën ta kualifikojë si të bazuar, të obligohet AK që lëndën ta kthej në rivlerësim dhe në përputhje me Nenin 1 dhe 7 të LPP-së të merr vendim të duhur dhe korrekt dhe jo të bie pre e pretendimeve të ulëta, jo profesionale dhe mbi gjitha jo korrekte të GOE i cili vetëm tenton të bëjë çmos që të mënjanohet kriteri i dhënies së ofertës oferta e përgjegjshme çmimi i ulët dhe kështu të manifestoje me llojë e llojë veprimesh vetëm që të arrijë qëllimet e veta që ne i konsiderojmë veprime shumë të ulëta dhe veprime për keqardhje!.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
		Kërkesa 1 Garancion nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit mbi garancion i cili duhet të jetë prej minimum 24 muaj nga data e pranimi finale të furnizimeve.	Dëshmi 1 Deklarate nga prodhuesi i autorizuar i prodhuesit mbi garancion minimum 24 muaj.
		Kërkesa 2 Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilën është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.	Dëshmi 2 Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilën është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.
		Kërkesa 3 OE është i obliguar ta beje servisimi montimin e pjesëve nën garancion brenda territorit të Prishtinës ose një distancë jo më të largët se 15 kilometra nga Flota Operative bazuar në rrugën me të afërt tokësore të asfaltuar. OE i jepet mundësia që të lidhe kontrate me ndonjë servisë i cili gjendet brenda rrezes (15km).	Dëshmi 3 OE duhet të sjellë Deklaratë Lokacioni i servisit (adresa) , Flota Operative Lokacioni i OE. Po qesë OE ka objektin e servisit me qira duhet të prezantohet marrëveshja mes operatoreve. Marrëveshja duhet të jetë e noterizuar.
		Kërkesa 4 -OE është e obliguar të sjellë Deklaratë me shkrim për plotësim të kërkesave të AK Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun programin për pjesë rezerv) për modelin e autobartës ne fjalë , po ashtu kompania fituese është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njëjtit të pajisen me çertifikata.	Dëshmi 4 -Kërkesa 4-OE është e obliguar të sjellë Deklaratë me shkrim të nënshkrimit të kontratës të na furnizon me Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun programin për pjesë rezerv) për modelin e autobartës ne fjalë , po ashtu kompania fituese është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njëjtit të pajisen me çertifikata.

SPECIFIKACIONET TEKNIKE për Autobartëse(merimangë)me plato lëvizëse hidraulike + kran		SASIA	MODELI DHE SPECIFIKACIONET ME TE CILIN OFERTONI (OBLIGATIVE)
		1	
1	Lloji i ngjyresë : e bardhë		
2	Fuqia e motorit : min 324 PS		
3	Klasa e emitimit të gazrave : min Euro 6		
4	Kapaciteti i ulësve : min1+1		
6	Sistemi i frenimit: min ABS		
7	Sistemi i drejtimit : Servo Hidraulik- Timoni në anën e majt.		
8	Karburanti: Diesel		
9	Tërheqja 4x2		
10	Nr. i Akseve 2		
11	Tahografi elektrik me disk fleta 24 orëshe		
12	Pesha totale e lejuar min 18000kg		
Kran Hidraulik			

13	Pozicioni I instalimit:Pas kabinës,para platformës		
14	Kapaciteti ngritës në 5 metra min 2.65 t		
15	Rrotullim min 360°,me sistem hidraulik		
16	Stabilizatorë Hidraulikë, me zgjatje anësore deri në 5.6 m		
Dimensionet-Platforma			
17	Çikriku hidraulik:min 5t		
18	Materiali:Çelik me trajtim kundër korrozionit		
19	Kapaciteti I ngarkesës:min 7.5 t		
20	Gjatësia e platos (m): min 6.3		
21	Gjerësia e platos (m): min 2,35		

Garancioni i autobartëses duhet të jetë garancion i plotë **24** muaj, në çmimin e autobartësës duhet të përfshihen edhe servisimet e rregullta (vaji, filterat-set si dhe frenat)brenda periudhës garantuese. Autobartësja duhet të jetë e re me vit të prodhimit identik me vitin e urdhërblerjes. Paisjet standarde minimale; ,drita për mjegull,drita rotative mbi kabinë(komplet gjerësia e kabinës),paisjet për përforsim të ngarkesës,dy drita mbrapa në kabinë për ndriqim të ngarkesës.Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me : "Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun /programin për pjesë rezerv)" për modelin e autobartësës ne fjalë , po ashtu kompania fituese është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njejtit të pajisen me çertifikata.

Obligative

autobartësja duhet të jetë e prodhuar me standard Evropiane .

Pjesët kryesore të automjetit(motorri,shasia dhe kabina duhet të jenë nga i njëjti prodhues).

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

PROCESVERBALI PËR EKZAMINIMIN , VLERËSIMIN DHE KRAHASIMIN E TENDERËVE

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë administrative:

Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve lidhur me përshtatshmërinë teknike:

1.	Gazmend Bojku B.L. 810402826	OE ka deshtuar ne kriterin si ne vijim: Kërkesa 4-OE eshte e obliguar te sjelle Deklarate me shkrim per plotesim te kërkesave te AK Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun programin për pjesë rezerv) për modelin e autobartses ne fjalë , po ashtu kompania fituse është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njejtit të pajisen me çertifikata. Deshmi 4-Kërkesa 4-OE eshte e obliguar te sjelle Deklarate me shkrim te nenshkruar dhe vulosur per plotesim te kërkesave te AK Kompania fituese është e obliguar që në momentin e nënshkrimit të kontratës të na furnizon me Paisje për diagnostifikim kompjuterik dhe CD (katalogun programin për pjesë rezerv) për modelin e autobartses ne fjalë , po ashtu kompania fituse është e obliguar që të bëjë trajnimin e së paku dy mekanikëve të autoritetit kontraktues dhe të njejtit të pajisen me çertifikata OE nuke e ka plotesuar deklaraten OE gjithashtu ka deshtuar ne Aneksin 1 te DT :SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME Ne Aneks eshte kerkuar: MODELI DHE SPECIFIKACIONET ME TE CILIN OFERTONI (OBLIGATIVE) OE nuk e ka plotesuar tabelen e Specifikacioneve Teknike edhe pse ka qene obligative Andaj OE eshte e papergjegjeshme per arsyet me larte dhe oferta l refuzohet
2.	"KOSOVA MOTORS GROUP" " S H.P.K. 601121271	OE ka deshtuar ne kriterin si ne vijim: Ne DT dhe Njoftim per Kontrate eshte kerkuar si ne vijim: Kërkesa 1 Garancion nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit mbi garancion i cili duhet te jetë prej minimum 24 muaj nga data e pranimi finale te furnizimeve. 1. OE ka sjelle deklarate ne kundërshtim me kriterin e AK, ku ka ofruar 24 muaj/150.000km. Andaj ky kushtezim eshte l papranueshem.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender**” me numër të prokurimit: “**214/30400-25-11147-1-1-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

		2. Ne Aneks është kërkuar : drita rotative mbi kabinë(komplet gjerësia e kabinës) OE ka sjelle automjetin me 2 drita rrotative (anesore të kabines dhe jo në gjerësi të kabines). OE gjithashtu ka deshtuar në Aneksin 1 të DT si: Ne pozicionin 11 të specifikacioneve teknike: <table border="1"> <tr> <td>11</td><td><u>Tahografi elektrik me disk fleta 24 orëshe</u></td></tr> </table> OE ka ofruar si në vijim: Tachograph, digital, with telecommunication (as per DSRC), CONTINENTAL 0P5DV Tahografi i cili është ofruar është në kundërshtim me kërkesën e AK, sepse OE ka ofruar Tahograf digjital dhe jo Tahograf analog me 24 fleta . Andaj OE është e papërgjegjshme për arsyet me lartë dhe oferta I refuzohet	11	<u>Tahografi elektrik me disk fleta 24 orëshe</u>
11	<u>Tahografi elektrik me disk fleta 24 orëshe</u>			
3.	Grup i Operatorëve Ekonomik AGS Corporation SH.P.K.; Auto Kaçandolli SH.P.K.	OE I ka plotësuar të gjitha kriteret administrative dhe Teknike dhe rekomandohet për kontratë		
4.	Ideal Shala B.I. 810252114	OE ka deshtuar në Aneksin 1 Specifikacionet Teknike 1. poz. 11 Tahografi elektrik me disk fleta 24 orëshe OE nuk e ka ofruar në katalog 2. poz. 17. Çikriku hidraulik: min 5t Në katalog nuk është deshmuar 3. poz. 18. Materiali: Çelik me trajtim kundër korrozionit Në katalog nuk deshmohet. Bazuar në nenin 59 dhe 72 të LPP-se kemi mundur të kërkojmë sqarim por nuk do të sjellte ndryshim rezultati. Andaj OE është e papërgjegjshme dhe oferta I refuzohet		

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues është pale me interes sipas nenit 4.1.26 të LPP-se

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - "KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.

Eksperti në pajtim me legjislacionin në fuqi ka analizuar të gjitha pretendimet e ngritura nga OE ankues dhe vlerëson se OE ankues fillimisht ka ngritur ceshtjet për eliminimin e ofertës së tij nga procedura dhe pastaj ka ngritur 3 pretendime për OE të rekomanduar.

Eksperti shqyrtues fillimisht ka shqyrtuar dhe paraqitur pretendimet në lidhje me ceshtjet e eliminimit të OE ankues si më poshtë:

Pretendimi ankimor për Deklaratën e Garancionit

OE në këtë pretendim ankimor nuk është pajtuar me vlerësimin e AK sa i përket kërkesës së kapacitetit teknik dhe profesional Kërkesa 1 në lidhje me garancionin nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, OE ka deklaruar se AK ka bërë vlerësim jo korrekt dhe të pabazuar pasi që e ka eliminuar OE për arsye se OE ka ofruar deklarate në kundërshtim me kriterin e AK ku ka ofruar garancion 24 muaj/150.000km. OE ankues pretendon se ka ofruar deklaraten për garancion 24 muaj duke dhënë edhe sqarimet që janë cekur edhe në pikën ankimore.

OE ankues në të njëjtin pretendim deklaroi se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së duke cekur se OE i rekomanduar për kontratë në katalogun e tij e ka të njëjtin kriter duke cituar pershkrimin e Ueb faqes zyrtare të prodhuesit.

Përgjigje nga eksperti shqyrtues

Eksperti shqyrtues ka analizuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe pretendimin ankimor për deklaratën e garancionit si dhe dokumentet e ofruara nga OE ankues dhe OE i rekomanduar për kontratë.

Kërkesa sipas FDT:

***Kërkesa 1** Garancion nga prodhuesi apo distributori i autorizuar i prodhuesit mbi garancionin i cili duhet të jetë prej minimum 24 muaj nga data e pranimit finale të furnizimeve.*

***Dëshmi 1** Deklarate nga prodhuesi ose distributori i autorizuar i prodhuesit për garancionin minimum 24 muaj.*

OE ankues për këtë kërkesë ka ofruar dëshminë “Deklaratë Garancionit” e dt. 9 shkurt 2026, në të cilën ceket se garancioni vlenë për periudhën 24 muaj dhe 150.000 km, varesisht se cila konsumohet e para.

Dëshmi:

Procurement number: **FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender 214/30400-25-11147-1-1-1**

Date: February 9th 2026

We, **MAN Importer Hrvatska d.o.o., Zastavnice 25/c, 10257 Brezovica, Hrvatski Leskovac, Croatia**, hereby state that warranty of the **MAN** chassis with cab is in duration of 24 months/150.000 km (depending on whichever expires first) from the date of the first registration.

Pavaresisht që OE ankues ka ofruar sqarimet se në një dokument tjetër të dosjes së tenderit që është **“Letër Autorizimi”** pershkruhet garancion prej 24 muajsh, Eksperti shqyrtues vlereson se deklarimi i dhënë në **“Deklaratën për Garancion”** prej 24 muaj apo 150.000 km (varesisht se cila konsumohet e para) është në kundërshtim me kërkesën numer 1 të nenit 9.1&9.2 - Kapaciteti teknik dhe profesional të FDT, pasi që kërkesa e dosjes së tenderit ishte vetëm për 24 muaj dhe nuk është kërkuar fare kufizim në km.

Sa i përket pretendimit që edhe OE i rekomanduar e ka deklaruar të njëjtin kriter, kjo nuk qëndron sepse në deklaratën për garancion e cila është kërkesë e FDT-së, OE i rekomanduar ka ofruar garancionin prej 24 muaj pa dhënë kufizime tjera shtesë.

Deshmi:

Titulli: Deklaratë Garancioni
Për: POLICIA E KOSOVËS
Nga: Grupi i OE: AGS Coporation Sh.P.K. / Auto Kaçandolli SH.P.K.
Data: 30.01.2026
Titulli i projektit: “FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender
Numri i prokurimit: 214/30400-25-11147-1-1-1

Deklaratë Garancioni

Ne, grupi i OE: AGS Corporation Sh.P.K dhe “Auto Kaçandolli SH.P.K. deklarojmë se të gjitha produktet e ofruara në tenderin me titull **“FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender** me numër të prokurimit **214/30400-25-11147-1-1-1** janë me garancion 24 muaj dhe në çmimin e autobartësë përfshihen edhe servisimet e rregullta (vaji, filterat-set si dhe frenat) brenda periudhës garantuere ato do të kryhen sipas manualit të prodhuesit për servisime.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor për Tahograf dhe Dritë Rotative

OE në vazhdim ka deklaruar edhe dy çështje për të cilat është eliminuar oferta e tij që kanë të bëjnë me Tahograf dhe dritën rotative duke deklaruar që çështja e Tahografit i plotëson kriteret me përplotmëri dhe do e liferojnë produktin në përputhje të plotë me specifikimet teknike.

Po ashtu OE ankues ka shfaqur edhe predomin për dritën rotative ku është deklaruar se e njëjta përputhet në përplotmëri me specifikimet teknike, duke theksuar se t'i referohen katalogut për te vertetuar përputhshmërinë e tyre.

Përgjigje nga eksperti shqyrtues

Eksperti shqyrtues ka analizuar çështjet e ngritura nga OE ankues sa i përket Tahogafit dhe Dritës Rotative duke i analizuar edhe kërkesën në Specifikimet Teknike (ST) sipas Aneksit 1 të DT.

Në ST lidhur me këto dy kërkesa AK ka kërkuar që:

Pika 11 Tahografi elektrik me disk fleta 24 orëshe, dhe nder të tjera

Paisjet standarde minimale; drita rotative mbi kabinë (komplet gjerësia e kabinës),

Në bazë të ST dhe katalogut të ofruar nga OE ankues, sqarimeve të dhëna nga OE, eksperti vlerëson se përshkrimi për tahograf në katalogun e ofruar nuk përputhet me përshkrimin e kërkuar në dosjen e tenderit.

Specifikimi sipas katalogut të ofruar nga OE ankues:

Tachograph, digital, with telecommunication (as per DSRC), CONTINENTAL 0P5DV

Gjithashtu eksperti shqyrtues ka shqyrtuar edhe ceshtjen e dritës rotative dhe sqarimet e dhëna nga OE, për të cilën vlerëson se në bazë të katalogut të ofruar nga OE ankues, përshkrimi për dritën rotative është në pajtim me kërkesën e ST në dosje të tenderit.

Specifikimi sipas katalogut të ofruar nga OE ankues:

Hazard warning light, 1 units, with continuous light function 0P3FF

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi për ceshtjen e Tahografit është i pabazuar ndërsa sa i përket Dritës Rotative pretendimi është i bazuar.

Vlerësimi i ekspertit shqyrtues në pretendimet ankimore ndaj OE të rekomanduar:

Pretendimi ankimor 1 ndaj OE të rekomanduar

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2- Kërkesa 2 Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilën është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.

Dëshmi 2 Katalog nga prodhuesi me përshkrim të detajuar, me të cilën është e mundur vlerësimi sipas specifikacioneve teknike të kërkuara.

OE ankues ka pretenduar që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka ofruar katalogun nga prodhuesi siç është kërkuar në kërkesën e dosjes së tenderit. OE ankues në këtë rast ka paraqitur dëshmitë se katalogu i ofruar është i hartuar nga vetë ofertuesi e jo nga prodhuesi.

Përgjigje në pretendimin ankimor 1

Eksperti shqyrtues vlerëson se dokumenti i dorëzuar nga OE i rekomanduar për kontratë, pavarësisht marrëveshjeve dhe autorizimeve të paraqitura, nuk është katalog i lëshuar nga prodhuesi. Meqenëse dosja e tenderit ka kërkuar në mënyrë të qartë “Katalog nga prodhuesi”, dokumenti i ofruar nuk është Katalog nga Prodhuesi, por është një dokument katalog alternativ i hartuar nga vetë ofertuesi.

Eksperti shqyrtues sqaron se në këtë rast mungon “Katalogu nga prodhuesi” siç është kërkuar në dosjen e tenderit.

Sipas Udhëzimit Administrativ nr. 002/2024, (neni 10) për sqarimin e tenderëve gjatë vlerësimit, autoriteti kontraktues ka të drejtë që gjatë fazës së vlerësimit të kërkojë informata sqaruese, në rastet kur mungon katalogu.

Prandaj, çështja mund të trajtohet në rivlerësim duke kërkuar sqarime shtesë nga operatori ekonomik, pa ndryshuar përmbajtjen thelbësore të ofertës.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar, të kërkohej informata sqaruese konform Udhëzimit Administrativ.

Pretendimi ankimor 2 ndaj OE të rekomanduar

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar nuk e ka ofruar sistemin e drejtimit sipas kërkesës së dosjes së tenderit *"Sistemi i drejtimit: Servo Hidraulik-Timoni në të majt"* por në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë është paraqitur sistemi i drejtimit *"Power steering Hydraulic pump, controlled"*. Sipas OE ankues ky lloj sistemi është sistem drejtimi elektronik.

Përgjigje në pretendimin ankimor 2

Eksperti shqyrtues, pas analizës teknike dhe konsultimeve profesionale si dhe burimeve relevante të siguruar nga publikime të ndryshme që e sqarojnë këtë sistem drejtimi, ka vlerësuar se sistemi *"Power steering Hydraulic pump, controlled"* është një sistem i drejtimit me asistim hidraulik (servo hidraulik). Në këtë kuptim, ai konsideron se sistemi i ofruar është në përputhje me kërkesën e përcaktuar në dosjen e tenderit.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 2 është i pa bazuar.

Pretendimi ankimor 3 ndaj OE të rekomanduar

OE ankues e ka kontestuar letër konfirmimin zyrtar të lëshuar nga prodhuesi Mercedes-Benz në drejtim të distributorit të saj në Maqedoni, ku ndër tjerash konfirmohet se validiteti i saj është i vlefshëm deri më 31 Dhjetor 2026. OE e ka kontestuar dokumentin për shkak të validitetit të dokumentit i cili nuk përfshinë periudhën prej 36 muajsh.

Përgjigje në pretendimin ankimor 3

Eksperti shqyrtues ka analizuar pretendimin ankimor si dhe kërkesat e dosjes së tenderit. Në lidhje me këtë pretendim eksperti konsideron se kjo nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit. Ndërsa sa i përket palëve të treta, AK nuk mund të paragjykojë marrëdhëniet kontraktuale mes tyre. Eksperti shqyrtues konfirmon se në momentin e ofertimit marrëveshjet e paraqitura kanë vlefshmëri.

Eksperti shqyrtues konsideron se pretendimi ankimor 3 është i pa bazuar.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE **"KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**", lidhur me aktivitetin e prokurimit **"FURNIZIM ME AUTOBARTËSE (MARIMANGË) PËR PK-në-Ritender"** me numër të prokurimit: **"214/30400-25-11147-1-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **"KOSOVA MOTORS GROUP " S H.P.K.**

Bujar Kuçi

